



---

PROCESVERBALI

Mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) në Rahovec, e mbajtur më **26.04.2018** me fillim në ora **10.15**. Mbledhjen e kryesoi Kryetari Komunës **Smajl Latifi**: Kuorum për mbajtjen e mbledhjes kemi.

**Kryetari**- Më lejoni ti përvendos të gjithë të gjithë anëtarët e KKSBB, Nënkyetarin e komunës, Fatmir Iska, Drejtoret e Drejtive, zëvendës komandantin e stacionit të policisë në Rahovecit z. Bekim Vuçitërna, Përfaqësuesit e organizatave, institucioneve që e përcjellin këtë takim të rregullt të KKSBB-së, FSK-së, KFORIT, përfaqësuesit e klerit fetar, përfaqësuesit e mediave dhe gjithë të pranishmit e tjerë që janë prezent në sallë. Ky është takimi i tretë për vitin 2018 i KKSBB-së. Propozoj këtë rend dite:

## REND DITE

1. **Informimi rrëth Gjendjes së Sigurisë së Përgjithshme në Komunën e Rahovecit, (Konkluzat).**
2. **Të ndryshme.**

**Kryetari** - E qes në votim rendin e ditës: Konstatoj se në mënyrë unanimë është aprovuar rendi i ditës. Para vete e kam procesverbalin nga takimi i kaluar, këtu janë të shënuara të gjitha ato gjëra të cilat i kemi trajtuar, qëndrimet të cilat i kemi marrë nga mbledhja e kaluar. Meqenëse është hera e parë që po e pranoj një procesverbal të këtillë, po e qes në aprovim: Konstatoj se në mënyrë unanimë është aprovuar edhe procesverbal i mbledhjes së kaluar. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

**1. Informimi rrëth Gjendjes së Sigurisë së Përgjithshme në Komunën e Rahovecit, (Konkluzat).**  
**Kryetari** – Komuna e Rahovecit vazhdon të mbetet me gjendje të sigurisë stabile dhe të qetë, sipas të gjitha informacioneve dhe rrëthanave të cilat ne i analizojmë në përputhje me kompetencat tona si Komunë mendojmë se është kështu, sigurisht se në këtë çështje mundet të kontribuojë secili nga ju, posaçërisht përfaqësuesi i stacionit të policisë në Rahovec të cilin sot e kemi këtu prezent. Ne si Komunë i marrim njofimet ose raportet në baza ditore për të gjitha zhvillimet të cilat kanë të bëjnë me çështjet e sigurisë të rendit publik, mundem të ju them se ne i kemi pasur disa zhvillime të cilat nuk e kanë cenuar aspak thelbin e asaj që ka të bëjë me sigurinë e përgjithshme të qytetarëve të Komunës së Rahovecit. Para vete e kam një raporte se sa zjarre dhe sa intervenime emergjente janë bërë nga njësiti i zjarrfikësve, po ashtu i kam edhe raportet e policisë, kam disa kërkesa ose rekomandime të cilat vijnë nga Drejtoria e Inspektoratit, të cilat kanë të bëjnë me rrënimin e disa objekteve të cilat janë me rezik potencial për jetën e qytetarëve tanë. Në procedurë të rrënimit të objekteve që paraqesin rezik për banorët deri më tanë i kemi 6 objekte ato janë: Shkolla e vjetër "Lidhja e Prizrenit" në Opterush, objektin e vjetër të shkollës "Mustaf Ibishi" në Kramovik, kemi një ndërtim pa leje përball restorant Esra Palace, objekti i vjetër i Postës në Krushë të Madhe, ish stacioni i policisë në Ratkoc, ish objekti i gjimnazit në Ratkoc. Kemi edhe disa pozicione të cilat në takimet e radhës mundemi të i prezantojmë si situata të cilat kërkojnë trajtim nga organet komunale si dhe kontributin ose rolin e partnerëve ose mekanizmave siç është KKSBB-ja, kemi evidentuar edhe situatat të cilat e cenojnë jetën e qytetarëve si mungesa e ndriçimit publik, pastaj mungesa e kamerave të sigurisë, ne disponojmë edhe listën se ku ka nevojë, sigurisht në bashkëpunim me policin e Kosovës dhe Drejtoretë Komunale ne do të kemi situata ose mundësi për ti realizuar. Kmei po ashtu probleme me situatën që lidhet me rrëth rrotullime, pastaj me mungesa të shenjëzimit të mjafsheshëm, mungesë të semaforëve, mungesë të disa pozicioneve që mungojnë dhe mundet të vije deri tek ndonjë rezik. Ne jemi duke përgatitur një plan i cili ndihmon në rritjen e sigurinë e përgjithshme të qytetarëve dhe të pronave familjare.

Për ma shumë detaje nuk do të isha lëshuar, por mundem të konstatoj se situata e përgjithshme në Komunën e Rahovecit vazhdon të mbetet e qetë, stabile dhe e qëndrueshme.

**Bekim Vuçitërna** – Zëvendës Komandant i stacionit Policor Rahovec, Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, para jush do paraqes gjendjen e sigurisë për periudhën reportuese Mars – Prill 2017 -2018. Sipas vlerësimit tonë ju paraqesim se situata e sigurisë në Komunën e Rahovcit paraqitet e qetë dhe stabile, jo me ndryshime të mëdha në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Sa i përket rendit dhe Qetësisë Publike - Rastet të raportuara lidhur me rendin dhe qetësin publike në periudhën reportuese janë: 3 raste për prishje të rendit dhe qetësisë publike, kurse në periudhën e njëjtë në vitin e kaluar kemi pasur 2 raste të prishjes së rendit dhe qetësisë publike.

Kurse sa i përket protestave - Janë mbajtur 2 protesta në Komunën tonë, me datë 23.03.2018, protesta e organizuar nga rrjeti i Grave të Kosovës e cila është mbajtur para Gjykatës së Rahovcit, ku kanë marrë pjesë afro 20 protestues. Protesta ka kaluar pa ndonjë incident. Protesta e dytë është mbajtur me datë 20.04.2018 dhe është organizuar nga tifozët e basketbollit të Rahovcit të quajtura "Vreshtarët". Kjo protestë është paralajmëruar si e qetë dhe është aprovuar si e ligjishme nga stacioni policor i Rahovcit. Protesta ka filluar në formë marshi, ku mbi 100 protestues me pankarta në dorë me kërkesë duke brohoritur për finalizimin e palestrës sportive, ku kanë lëvizur në grupe nga stacioni i autobusëve, rrugës kryesore, nëpër qendër e qytetit e deri tek oborri i Komunës së Rahovcit. Protesta ka kaluar e qetë, pa ndonjë dhunë, pa dëme materiale, pa lëndime në njerëz, përvèç dy personave nga grupi i protestueseve të cilët kanë vepruar me tendencë në eskalim të situatës drejt dhunës. Por në fund gjithçka ka kaluar mirë pa ndonjë incident të raportuar.

**Kriminaliteti** – Rastet penale gjithsej të iniciuara për periudhën reportuese krasuan me vitin paraprak janë 84/56, dy raste të fundit kemi pasur me vjellje të rëndë të raportuara në fillim të javës, ku në një rast është vjedhur banka (AFK), ku 4 persona të maskuar e kanë hapur derën e hyrjes me forcë dhe kanë vjedhur komplet sefin me para të gatshme. Po ashtu atë natë është thyer edhe një barnatore afér QKMF-së në Rahovec. Lidhur me këto raste policia ka ngritur një grup punues dhe intenzivishtë janë duke punuar për ndriçimin e rasteve, ku në kuadër të punës operative hetimore të angazhuar janë policë hetues të stacionit rajonal të Gjakovës dhe stacionit policor të Rahovcit.

Ndërsa si vepra penale më serioze që janë të iniciuara janë: Lëndime të rënda trupore 1, lëndime të lehta trupore 9, grabitje nuk kemi pasur të raportuara, vjedhje të rëndë 16, vjedhje 6, vetëvrasje nuk kemi pasur, tentim për vetëvrasje 2. Gjithmonë flasë për periudhën reportuese mars - prill 2018.

Sa i përket armbajtësve pa leje – Armëmbajtje pa leje kemi pasur 1 rast, armë të konfiskuar 1, kurse munizione 18.

Aktivitetet në Komunikacionin rrugor – Aksident me fatalitet nuk kemi pasur, aksidente me lëndime 22 së bashku me trafikun rajonalë të Gjakovës, aksidente me dëme materiale 9, tiketa të shqiptuara për kundërvajtje në trafik në të njëjtën periudhë reportuese vitin e kaluar kemi pasur 1255, kurse tanë kemi vetëm 738 tiketa.

**Arrestimet** – Sipas autorizimeve totale kemi pasur 10 arrestime, në mbajtje kemi pasur 10 persona, urdhëresa të realizuara gjykatës dhe prokurorisë kemi pasur 57, asistencë nëpër institucione të ndryshme për dy muaj mars/prill kemi pasur 42 raste.

Sa i përket aktivitetave policore vetëdijesuese policia në komunitet ka mbajtur ligjérata nëpër shkolla me tema : Stop droga nëpër shkolla, lëvizni të sigurte në trafik, delikuencia e të miturve. Numri i ligjératave të mbajtura janë 16, nxënës të përfshirë në ligjérata 388, kurse 13 shkolla të përfshira në këto projekte. Sa i përket projektit lëvizni të sigurte në trafik janë shpërndarë 755 fletushka me udhëzime për nxënës rrëth sigurisë në shkolla, ku janë përfshirë 8 shkolla. Kjo ishte sa i përket raportimit nga ana jonë, por ne i nderuari Kryetar kemi edhe disa shqetësimë të cilat do ju kisha shpalosur këtu në këtë mbledhje. Ne si stacion i policisë në Rahovec e kemi një shqetësim të kamotshëm i cili ka të bëjë me shërbimet e bartjes së automjeteve (Merimanga) nuk funksionon, ka nevojë që ky shërbim të funksionalizohet, është e kushtueshme dhe shpenzuese për qytetarët e Rahovcit sepse enë rast të aksidenteve të trafikut ose nëse bëhet konfiskimi i automjetit ne duhet këto shërbime ti kërkojmë nga Komunat fqinje si Malisheva, Gjakova ose Prizreni, kjo është e kushtueshme pasi llogaritet në kilometër. Shqetësimi tjetër është usurpimi i trotuareve i cili është i dedikuar për lëvizjen e këmbësorëve, disa nga bizneset në rrugët kryesore i kanë vendosur karrikat dhe tavolinat nëpër trotuare, pra e gjithë kjo hapësirë është usurpuar nga ane bizneseve dhe këmbësorët janë të

detyruar të lëvizin nëpër rrugë ku i rrezikohet edhejeta e tyre. Ka disa biznese që bëjnë edhe reklamimin e produkteve që i shesin dhe i nxjerrin nëpër trotuare, kishte me qen mirë që të dalin në teren inspektorati nëse ka nevojë edhe ne do të dalim në asistencë që të identifikohen ata pronar që e bëjnë usurpimin e trotuareve dhe të mirën masa ligjore ndaj tyre. Po ashtu kemi edhe një shqetësim sa i përket degradimin të ambientit, hedhja e mbeturinave si ato të ngurta dhe ato të amvisërisë, hedhja e ushqimit mundeni të i shihni kudo si në rrugë kryesore ashtu edhe nëpër fusha, lumenj etj. edhe për këtë kërkojmë nga Drejtoria e Inspektoratit që të marrin masa më konkrete që të dalin në venin e ngjarjes dëhe të marrin masa konkrete. Tani jemi afër festave të mbrëmjes së maturës, përvëç mbrëmjes së maturës organizohen para kësaj mbrëmje edhe disa manifestime të ndryshme nëpër oborre të shkollave dhe jashtë saj, si në parkun e qytetit ose diku në periferi të qytetit. Shumë shpesh për këto tubime ~~nuk~~ jemi të njoftuar si polici, në kësi organizime mblidhen jo vetëm nxënës por ka edhe nga tata që nuk janë nxënës dhe në kësos raste mundet të vije deri tek konfliktet, prandaj është mirë që në kësos raste cdo herë të jetë e njoftuar policia e Kosovës nga përgjegjësi i shkollës, ose nga drejtori i shkollës. Shqetësim tjetër kemi për arsy se nuk kemi një ekip emergjent shpesh mbesim në situata të këqija në raste kur kemi aksidente me lëndime ose aksidente të tjera ku është nevoja që të del ekipi emergjent i ndihmës së shpejtë në vendin e ngjarjes. Mendoj se për këtë duhet që të bisedoni edhe me Drejtorin për shërbime shëndetësore sepse shërbimi që e ceka më lartë është shumë i nevojshëm dhe domosdoshëm për shpëtim jete.

**Fadil Sylka** - Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, desha të ndërlidhem sa i përket shqetësimeve që lidhen me bizneset, e përmendi togeri se disa biznese i uzurpojnë trotuaret dhe pengohen këmbësorët, personalisht kam një mendim ndryshe nga togeri, prandaj mendoj se bizneset duhet që ta zhvillojnë veprimtarin e tyre, por të shikohet mundësia që ti kufizohet se sa kanë të drejtë të reklamojnë mallin e tyre e jo të i ndalohet e gjitha. Nëse bëhet kjo atëherë ne jemi duke i favorizuar vetëm bizneset e mëdha, prandaj ne duhet që të përshtatemi që këto biznese të funksionojnë e jo të mbyllen e pastaj të krijohet barra për shtetin, pra të bëhen raste sociale. Ne si biznese gjithmonë e kemi pasur një problem me policin gjatë kundërshtimit që gjatë blerjes automjetet të mos gjobiten, pra të lejohet ndalimi i makinës para lokalit për 5-10 min deri sa ai ta kryej blerjen sepse nëse gjobitet atëherë ai klientë asnjëherë nuk do të vije atë lokal, blerësit tanë shkojnë nëpër komunat e tjera dhe prandaj ne gjithmonë jemi më keq se të tjerët.

**Lulzim Krasniqi** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, desha të ndërlidhe rreth rasteve të sigurisë nëpër shkolla, jam edhe në rolin e anëtarit Komunal të Këshillit të prindërve. Në një mbledhje të mbajtur në gjimnazin e shkollës profesionale “Selajdin Mullabazi”, në konsultë me profesor dhe udhëheqës të gjimnazit morën disa informata shqetësuese për sigurinë e nxënësve, e para nxënësit nuk e vijojnë mësimet në kohën e caktuar në mëngjes kryesisht maturantët, pastaj nëpër shkolla gravitojnë persona të panjohur për nxënës dhe stafin e shkollës, pastaj në orët e fundit nuk mbahet mësim. Stafi i udhëheqësve dhe drejtori i shkollës kërkonte nga ne si bord i prindërve një zgjidhje. Mendimi ynë ishte se duhet të ketë nëpër shkolla persona që janë zyrtarish të angazhuar për sigurinë dhe për hyrjet daljet e nxënësve, sepse nëse nuk kemi kështu diçka mundur të implikohen nëpër shkolla personat të cilët nuk ja donë të mirën shoqërisë sonë. Shqetësim tjetër ishte edhe matura e këtij viti e cila ishte duke u bërë ndarës në mes dy shkollave të mesme të qytetit, kjo nuk kishte logjik sepse mundësia e rrezikut për nxënës është më e madhe kur bëhet në dy ambiente të kundërtë. Shëtisim tjetër ishte që nxënësit gjatë kësaj dite të maturës të mos ngasin makina për deri tek ambientet që manifestojnë mbrëmjen e maturës, rast shqetësues është edhe rasti i djeshëm kur një nënës ka tentuat të vetëvritet sepse mësuesja ka kërkuar nga ai që ta sjellë prindin në shkollë, bëhet fjalë për rastin në shkollën “Bekim Sylka”, ky nxënës gjendet në spital në gjendje shumë të rëndë me rrezik edhe për fatalitet. Po ashtu mendimi ynë është që shkollat kanë nevojë për një psikolog, gjithmonë duke pasur parasysh mosfunkcionimin e trekëndëshit didaktik profesor – nxënës – prind, këto janë probleme dhe shqetësime të kamotshme por në ~~mësim~~ të mobilizimit tonë janë toleruar deri në këtë masë. Sa i përket shqetësimit për nxënien e trotuareve, tani në Rahovec jemi në kohën e produkteve bujqësore kur eksponohen produktet nëpër rrugë, ku pengohen njerëz me karroca, pengojnë nënët me fëmijë që ecin nëpër trotuare, prandaj i bëjë lutje Drejtorisë së Shërbimeve Publike që të përqendrohet në qasjen e trotuareve dhe më shumë liri për

qarkullim. Sa i përket shqetësimit për nxënien e trotuareve, tani jemi në kohën kur do të eksponohen produktet bujqësore në rrugë, i pengojnë njerëz me karroca, pleqtë, pengojnë nënat me fëmijë, prandaj mendoj se ~~kisha~~ me qen mirë që Drejtoria e Shërbimeve Publike të përqendrohet që të ketë më shumë qasjet në trotuarë dhe më shumë liri për qarkullim.

**Kryetari** – Do përpinqem që ti adresoj disa konkluza dhe të i japë disa përgjigje këtyre komenteve të cilat u ngritën. Çështja e protestave është e rregulluar me Kushtet dhe ne ligj, protestat janë të lejueshme natyrisht kur janë pa dhunë, secili qytetar ka të drejtë që të protestoj për një arsy, por natyrisht me ~~legj~~ ose njoftim paraprak nga policia, siç ishte ajo e protestueseve të tifozëve të cilët e kanë pasur ~~edhe~~ miratimin e plotë të Kryetarit të Komunës. Shfrytëzoj të drejtën që të kërkoj nga polica e Kosovës dhe të gjithë akterëve që kanë peshën e vetë tek qytetarët që të bëjnë fushatat e veta që të ketë sa ~~me~~ pak vepra penale, sa ~~më~~ pak aksidente në trafik. Ne jemi të vetëdijshëm për kufizimet e shumta madje edhe për situatën reale të cilën e kemi nëpër rrugë, po ashtu edhe për situatat të cilat i shpjegoj me ~~faktorë~~ togeri i policisë së Kosovës. Si konkluzë tjetër dhe rekomandim është: Objektet me rrezikshmëri të lartë të cilët mundën të cenojnë sigurinë e qytetarëve, nëse kushdo nga ju keni informata ju ~~tur~~ që ta sfidojnë pozitivisht Komunën dhe të lajmërohen tek ne, qofshin ato usurpime ose çfarëdo objekti i cili mundet të jetë rrezik për njerëzit, pastaj ne jemi të obliguar që të ndërmarrim një vizion se ~~çka~~ duhet që të bëjmë me to. Komunikimi dhe sensibilizimi për çështjet e sigurisë besoj se është në kuadër të përgjegjësive dhe detyrave që i kemi secili nga ne, secili anëtar i KKSB-së është i obliguar që të ~~risë~~ sigurinë nëpër shkolla, ta luftojmë të keqen dhe me i vetëdijesua se çfarë pasoja do të ketë nëse do të paraqiten, shenja ose sinjale, dukuri të cilat mundën ta rrezikojnë të ardhmen tonë qoftë në shkollat fillore e sidoqoftë për shkollat e mesme. Ne kemi vazhduar debatet në bashkëpunim me SHL-Kosova dhe policin Kosovës, për të arritur sigurinë nëpër shkolla, për ti zgjeluar mungesat në shkolla, për ti luftuar të këqijat në shkolla, po ashtu presim ndonjë rekomandim se a do të ketë rrethoja në shkolla, a do të ketë sigurim privat në shkolla, a mundemi të bëjmë më shumë terrene sportive në shkolla, në mënyrë që nxënësit tanë të i dëshmojnë vlerat e tyre në aktivitete sportive etj. Sa i përket auto bartjes së makinave ne do të diskutojmë me Drejtoren e Shërbimeve Publike pse Rahovecit i mungon auto bartja. Sa i përket qenve endacak vazhdojnë që të janë të rrezikshëm për qytetarët, i kemi çdo ku nëpër rrugë, në ambiente më të frekuentuar, por shpresoj se Komuna jonë do të jetë pjesë e strategjisë shtetërore për trajtimin e qeneve endacak. Nuk e di a ja kanë filluar me ndonjë Komunë por ~~ne~~ ende nuk kemi diçka zyrtare nëse ka filluar në ndonjë Komunë aktiviteti për trajtimin e qeneve ~~endacak~~. Degradimi i ambientit, po shfrytëzoj rastin që të ju njoftoj dhe të ju bëjë ftesë se me datë 2 maj 2018 fillon aksioni i madhe për heqjen e deponive ilegale si ato inerte, të amvisërisë apo të përziera, ky aksion nuk është aksion vetëm i Komunës por në këtë aksion do të përfshihen subjektit ekonomike, bizneset, të gjitha institucionet Komunale, policia e Kosovës, operator të cilët kanë marrëdhënie kontraktuale me Komunën e Rahovecit, po ashtu do të ketë përfshirje të shkollave tona si ato të mesme ashtu edhe ato fillore, OJQ-të e ndryshëm dhe vullnetar dhe aktivistë të shumtë të cilët e duan një ambiente më të pastër. Është shumë mirë që dita e tokës është shënuar në Rahovec dhe ky është një mesazh se në qytetin e vlerave të shumta është zgjedhë që të festohet dita e tokës. Po ashtu ju njoftoj se me datë 10 maj do të kemi një marshim në qytetin e Rahovecit të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) ~~me~~ qëllim që të dërgojmë mesazhin se FSK-ja është e Kosovës si dhe Rahoveci është pjesë e saj, besoj se do të jetë një ngjarje emirë ku do të përfshihen të gjithë. Sa i përket festave që janë duke i organizuar nxënësit e shkollave të mesme në veçanti maturantët, e ftoj DKA-në që ti drejtohet drejtoreve të shkollave që ata të njoftojnë për çfarëdo aktiviteti policin e Kosovës, në mënyrë që ata të ndërmarrin masa sepse kemi të bëjmë me një gjeneratë e cila ende nuk i ka mbushur 18 vite, e gjitha bëhet për ~~ta~~ parandaluar ndonjë incident. Sa i përket shërbimeve emergjente është ngritë edhe një herë kjo ~~çështje~~, ne kemi biseduar me mjekët e QKMF-së, ata nuk e ndajnë të njëjtin mendim me policin sa i ~~pë~~ ndihmës e cila ~~dimet~~ të jepet me kohë, por sidoqoftë pajtohem se shërbimi mobil duhet të jetë ~~efikas~~ dhe në ~~funksion~~. Ju siguroj se ne do ta trajtojmë me kujdes këtë çështje me Drejtoren e QKMF-së dhe të shëndetësie, ku do të shohim se çka mundet të bëhet dhe cilat janë obligimet tona ~~së~~ Komunë që të kemi një efikasitet më të lartë të shërbimit emergjent në Komunën tonë. Parkimi i ~~pa~~ lejuar i automjeteve si çështje u ngritë nga përfaqësuesi i bizneseve, e di se kufizime

për trotuare ka gjithkund, trotuaret i takojnë këmbësorëve dhe askujt tjetër, por kjo nuk nënkupton se nëse ka hapësirë të mos shfrytëzohet për eksposizime të produkteve të ndryshme. E ftoj policin e Kosovës sepse ka plotë automjete të parkuara të cilat e me ditë të tëra ose 24 orë janë të parkuar në trotuare dhe për këtë të ndërmerr masa, e dimë se ka mungesë të parkingjeve, po ashtu e dimë se angazhimi për të krijuar parkingje të reja nuk mungon as nga ana e juaj por as nga ana e Komunës, po ashtu e dimë se hapësirë për parkingje të reja ka shumë pak, por nga njëherë na shkon mënda tra parkojmë aty ku e kemi më afër dhe më lehtë. Pajtohem që të parkohen 5-10 minuta, ne së bashku me policin e Kosovës, inxhinerët e urbanizimit, ekspertë e komunikacionit, do të tentojmë duke mare edhe mendimin e komunitetit do të provojmë të bëjmë diçka rreth ndryshimit të qarkullimit të automjeteve në trafik, nuk jemi ka themi se do të bëjmë ashtu siç ka qenë dikur, por ka disa rrugë të cilat mundemi të i bëjmë një drejtimesh. Ishte një shqetësim sa i përket dëmtimit të varrezave, besoj se në traditën e qytetarëve të Kosovës nuk ka qen asnjë dëmtimi i varrezave, plakave përkujtimore etj, nuk është se kemi ndonjë situatë problematike të ~~pas~~, e di se ka element që i pëlqen ndonjë simbol dhe thotë që ta mare te shtëpia, por mendoj se nuk ~~është~~ aspak e ndershme nëse ne nuk angazhohemi që të gjithë, po ashtu edhe ju si anëtar të KKSBB-së që t'i ruajmë vlerat tona. Kemi 2-3 raste që na kanë ndodhur prandaj unë po ju apeloj anëtarët e KKSBB-së që të kenë kujdes edhe në emërtimin e rrugëve, ne kemi plotë vërejtje se kjo rrugë ndoshta është dashur të ketë emrin ndryshe etj, por nuk është mirë që të dëmtohen tabelat me emërtimet e rrugëve sepse janë investime direkte nga taksapaguesit tanë, po ashtu ky investim është duke u monitoruar nga komisioni i BE-së. Ne ato vërejtje mundemi që të adresojmë në Kuvendin Komunal dhe nëse na lejohet mundemi të bëjmë ndryshime, po nuk është e ndershëm të prihen tabelat. Nëse nuk ka diçka dikush të shtojë, konstatoj se pika e parë e rendit të ditës është e myllur, kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

## 2. Të ndryshme.

**Enis Berisha** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, desha të ndërlidhem rreth diskutimit të zëvendëskomandantit rreth murit të shkollës, a ka diçka të re. Sa i përket temave të sigurisë edhe ne në KLSP i kemi diskutuar, si çështja e qarkullimit të nxënësve, si mungesa e trotuareve sidomos tek Gjimnazet, kurse e përgëzoj kryetarin për fillimin e punimeve të trotuarit në një rrugë të rëndësishme në Rahovec. Shqetësim tjetër i imi është mungesa e ndriçimit tek shkolla e filllore ardhmëria.

**Kryetari** – Sa i përket trotuarit është një objekt aty ku diku 3 metra është në pronën e vetë dhe 3 metra në pronën komunale, pronari i atij muri na ka thanë që mundeni gjysmën me e prish dhe gjysmën tjetër jo, ne kemi mundësi me e pre, por nuk besoj se do të dele mirë, por besoj se shumë shpejtë do ta rregullojmë me marrëveshje me pronarin. Sa i përket atij problemi që e ceket tek shkolla ardhmëria, së pari është mirë që ne e kemi zgjidhur një problem në mes dy familjeve si ajo Zllanoga dhe Ejupi, besoj se aty do të ketë trajtim edhe të rrugës por edhe të rrethojës së shkollës.

**Bujar Morina** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, kam një kërkësë për Drejtorin e Inspektoratit, të nderuar në ditën e tregut të dielën në fshatin Ratkoc, bllokohen hyrjet - daljet e banorëve nga ana e shitësve, prandaj ju bëjë kërkësë që në ditën e tregut të i dërgoni inspektorët komunal dhe të i largojnë ata shitës nga dyert tona dhe të i dërgojnë në vendin e caktuar për treg.

**Ylvi Shehu** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, prita që do e ngris një shqetësim togeri i cili ka ndodhur para dy muajve mos gaboj, rruga ~~nga~~ Jaha Petrol e deri në Patoqan, asfaltimi i kësaj rruge që është bërë, por në pjesën e quajtur Rasoje është bërë shembje e asfaltit dhe kjo rrugë tani është rrezik permanent për bujqit, siç e dini tani është koha e stërpikjeve dhe e punimeve të tokave. Po ashtu shqetësimi tjetër është se tani ka fillimi i majit janë disa festa tradicionale si Shëngjergji, në këtë kohë shumë qytetarë kanë me frekuentua këtë rrugë si Patoqan dhe Krushe, policia e Kosovës gjithmonë në këto ditë është duke mare masa dhe për këtë veprim është për tu përshëndetur policia e Kosovës. Shumë njerëz janë duke i mbushur rimorkat e traktorëve me familjar, kurse ajo rrugë me distancë diku 20 metra dhe kjo rrugë është shumë e rrezikshme aty ~~munden~~ edhe të rrotullohen, si pas disa informatave dy makina janë rrotulluar. ~~Pas~~ kërkoj që kjo rrugë së paku të sanohet sepse është shumë emergjente, le të bëhet një herë e ~~kam~~shme e pastaj do i ndjekeni ju ato procedurat e tjera.

**Përparim Krasniqi** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, i nderuar i. Ylvi Shehu ne si Komunë jemi të njoftuar për këtë rrugë, kemi dalur ~~se~~ vendin e ngjarjes dhe kemi parë që ka shembje të dheut,

aty gjithmonë do të ketë shembje të dhet, ne kemi angazhuar një kompani e cila do të bëjë studimin e elaboratit të atij vendi se pse është duke lëvizur ajo tokë, në momentin që ata e bëjnë studimin ne do të ndërmarrim masa. Ne përkohësisht do të bëjmë atë rrugë të kalueshëm deri sa të na vije projektin detali se si duhet të veprojmë aty. Kompania vetëm sa ka filluar dje punimet që të bëjë të kalueshme këtë rrugë për festa e majit.


**Kryetari** – Besoj se më së largu deri pasnesër kjo rrugë do të bëhet e kalueshme sepse të gjitha ato që i tha baca Ylvi janë të vërteta.

**Nënkyetari i KLSP-së** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit fillimisht shfrytëzoj rastin ta falënderoj Kryetarin e Komunës i cili ka ndarë kohën që të na pranojë neve anëtarëve të KLSP-së, i cili ka dëshmuar gatishmërinë e tije që vetëm së bashku mundemi të ndikojnë në rregullimin e gjendjes së sigurisë së përgjithshme. Po ashtu përgëzoj interesimin e banorëve të fshatrave të cilët janë duke u kyçur në KLSP dhe janë duke e dhënë kontributin e vetë për ngritjen e gjendjes së sigurisë, në takimin e kaluar i kamë bëre disa pyetje sa i përket sinjalizimit të disa rrugëve dhe vjenien e disa tabelave sinjalizuese, pyetja ime është a ju është drejtuar Komuna ministrisë përshtatëse dhe nëse po a kanë mare ndonjë përgjigje nga kjo ministri. Falënderoj po ashtu Komunën për shtrimin e trotuareve nga ambulanca rrugës për në Malishevë, po ashtu desha të ju informoj se kam mbajtur një takim me këshilltarin e ministrit për kthim dhe komunitete, lidhur me realizimin e projektit për zgjerimin e rrugës “Bekim Sylka” si dhe vendosjen e trotuareve dhe ndriçimin publik po të kësaj rruge, ne kemi kërkuar donacion nga kjo ministri, prandaj i bëjë apel drejtore përgjegjëse që ti drejtohet Ministrisë për Kthim dhe Komunitete në mënyrë që ti marrim këto donacione për këtë projekt. Pyetje e fundit është ku keni mbërritur me rrugën tranzitore mbi qytetin e Rahovecit.

**Ramë Berisha** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, e kamë një problem sepse pusin që e kamë që nga vitet 1983 të cilin edhe sot e kësaj dite e përdori, por një fqinjë e ka hapur një gropë jo septike dhe që nga viti 2016 është duke ma ndotur pusin. I kam lajmëruar inspektorët dhe ata më kanë kërkuar që të bëjë analizën e ujit por deri më tanë asgjë nuk është ndërmarrë ndaj atik komshiu. Prandaj kërkoi nga ju që ato që janë më urgjente të merren masa sa më të shpejta.

**Kryetari** – Natyrisht që i ftojë të gjitha organet që të janë më efikase sepse kjo është edhe detyra jonë, po ashtu besoj se efikasiteti është shumë i rëndësishëm. Sa i takon shenjëzimit dhe sinjalizimit të rrugëve ne kemi probleme por besoj se edhe ne si Komunë por edhe ministritë përgjegjëse do të përkujdesen të mbërrimë tek zgjidhet më të mira dhe të i evitojmë rreziqet eventuale që vinë për shkak të mungesës së shenjëzimit të duhur. Ne ju kemi adresuar Ministrisë së Infrastrukturës për çështjet që i ngritët ju, është duke ndodhur procesi i shpronësimit dhe ky është tërësisht projekt i kësaj ministrie shpresojmë se do të kemi zhvillime pozitive në rrugën tranzitore. Ne e dimë se probleme të shumta të natyrës së përditshmërisë ka mjaftë, prandaj ne jemi këtu si KKSBB për të siguruar dhe transmetuar mesazhin tek qytetarët që do të përpinqemi që detyrat të i kryejmë më efikasitet, drejtë, shpejtë dhe mirë. Ju falënderoj për kontributin e dhënë në këtë takim, nëse nuk ka askush të ngris ndonjë shqetësim tjetër sa i përket kësaj pike e deklaroj të myllur këtë takim shihemi në takimin e radhës.

**Mbledhja përfundoi në orën 11:20**

  
 Procesmbajtës  
 Skendr Hamza